



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 20-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 30.06.2023, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Majlinda Sylejmani, anëtare
14. Gentianë Hoxhaj, anëtare
15. Venhar Agushi, anëtar
16. Xhyla Dedushaj, anëtare
17. Lulzim Rustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Egzona Bytyqi, anëtare
22. Lumturiye Bytyqi-Hasani, anëtare
23. Ganimete Qeriqi, anëtare
24. Alban Salihu, anëtar
25. Fitim Meziu, anëtar
26. Fadil Spahiu, anëtar
27. Fatmir Fetahu, anëtar
28. Shahadije Dragaçina, anëtare
29. Besiana Sylja, anëtare
30. Enver Kryeziu, anëtar
31. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i komunës
2. Diamnt Bytyqi, nënkryetar i komunës
3. Lulzim Qerimi, nënkryetar i komunës
4. Latif Ramadani DBF
5. Valon Pacolli, DEZH
6. Shkelzen Hajdini, DSH
7. Elmaze Behluli, DA
8. Sead Aliu, DI
9. Rexhep Rexhepi, DBP
10. Rasim Hasani, DA
11. Safete Amerrlahu, DGJK
12. Burim Rustemi, DSHPMSh
13. Bekim Shabani, DP
14. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha se pari ua uroj festën e Kurban Bajramit, duku ju dëshiruar shëndet dhe harmoni të gjithëve, pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 19-të e Kuvendit.
2. Propozim vendim mbi aprovimin e Korinizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026
3. Propozim Vendim për miratimin e planit komunal për riintegrim të qendrushëm të eproanve të riatdhesuar dhe integrim të të huajve në komunën e Lipjanit 2023-2025
4. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare Organizates "HELP"
5. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare për qendren për mbrojtje të viktimave të dhunes familjare dhe atyre të dhunes gjinore.
6. Propozim vendim për pezullimin e eprkoshëm të zbatimit të rregullores për orarin e veprimtarive ekonomike Nr.15-330/02-22376 të datës, 28.04.2023
7. Propozim rregullore për transportin e udhetarve me automjete taksi (Rishqyrtim)

Pastaj kryesuesi i kuvendit Daut Azemi, tha se do të keni edhe dy pika shtesë për të cilat po i kaloj fjalën drejtoreshës së Kultures Aniles, e cila do të ju njofton.

Anila Reqica-Llugiqi, tha se edhe une ua uroj festen e bajramit, po ashtu ju njoftoj se kemi dy pika ne redn te ditë per anulim, me arsyetimin se te dyja nuk janë te percaktuara me planifikim hapsinor dhe kërkoj nga ana juaj qe keto dy pika te anulohen.

8. Propozim Vendim për Anulimin e Vendimi 15NR.353/01-27907 i datës 31.05.2023 për caktimin e lokacionit për fushën sportive në zonën kadastrale Babush i Muhaxherëve i miratuar në mbledhjen e Kuvendit të mbajtur me datë 31.05.2023

9. Propozim Vendim për Anulimin e Vendimit 15NR.353/01-27908 i datës 31.05.2023, për caktimin e lokacionit për vendosjen e Memorialit të UÇK-së në zonën kadastrale Qylagë.

Daut Azemi, kryesues I kuvendit tha se keto pika janë kthyer nga MAPL-ja, por janë kthyer me vonesë dhe nuk pas tjetër zgjidhje pos me i anuluar.

Arsim Jashari, tha se a është anulim e vendimit apo çka se edhe nuk e kemi marr materialin?

Daut Azemi, tha se është anulim i vendimeve per shkak se këto zona nuk janë ta parapara ne planifikim hapsinor.

Pastaj kryesuesi tha se a pajtoheni qe te hyjne ne rend keto dy pika:

Me te gjitha votat prezente 26 hynen ne rend te dites pikat e propozuara

Pastaj Kryesuesi pyeti se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Me që diskutime tjera nuk pati, kryesuesi e hodhi në votim rendi i ditës i kompletuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 27 vota për, aprovoi rendin e ditës..

Pastaj u kalua në Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Albiona Tasholli, tha se unë ua uroj kurban Bajramin. E para e falënderoj kryetarin për bashkëpunimin e asamblenë komunale dhe realizimin e kërkesave tona të cilat i kemi ngritur ne kuvend e në veçanti për dy kërkesa të cilat i kam ngritur unë e të cilat janë te realizuara siç është renovimi i QMF në Gadime dhe renovimi i QMF në Janjevë. Po ashtu tha kam një kërkesë të banorëve të fshatit Akllap për zgjerimin e rrjetit të kanalizimit pasi qe është shumë i domosdoshëm.

Ganimete Qeriqi, tha se kam kërkesë nga disa aktiviste te viteve 90 -të qe te kërkoj nga ju qe te emërtohen rrugë te Lipjanit ne emër te grave ,aktiviste te viteve 90-ta-qe kishin marrë përgjegjësi te lëvizjes ne atëkohë e qe ska qene e lehte ,këto aktivitete e përgjegjësitë i kanë shtrirë ne te gjithë nëndegët Lipjan dhe kanë qëndruar afër qytetareve për çdo nevojë. Aktivitetin nuk e kanë ndërpre deri ne çlirim edhe deri sa ishin ne jetë, këto jen:Luljeta Rexhepi,Mevlude Azemi dhe Hajrije Salihu. E dyta , unë kam kërkesë për komisionin e nderuar qe pjesa tjetër e sheshit te emërtohet ne emër te Shtjefën Gjeçovit . Këndeje Adem Jashari andej Shtjefën Gjeçovi dhe ta ketë shtatoren pjesën tjetër ,Gjeçovi. Është nder për Lipjanin me kapitalizuar këtë figurë të ndritur. Gjeçovi është i nderuar anekënd ku ka shqiptarë por ne nderojmë veten dhe brezat qe vinë frymëzohen nga ky personalitet i madh. Gjeçovi e afirmoj shume kombin shqiptarë ,kontribuoj për shkollën shqipe ,kishte ideal përpilimin e Abetares dhe ta përhap në çdo shtëpi. Për këto veprimtari madhore, kralevina serbe e ndoqi hap pas hapi dhe ne Malësi te Hasit e privoj nga jeta. Gjeçovi la gjurmë te thella : arkitekture, etnologji, në te drejtën zakonore teatrale e te tjera. Ta shfrytëzojmë këtë mundësi t,i japin vlere Lipjanit mbase Gjeçovi ka lindur ne komun e Lipjanit

Arsim Jashari, tha se edhe unë në emër të grupit t grupit të PDK-së, ua uroj Kurban Bajramin. Po ashtu tha se kam për ti ngritur disa kërkesa te qytetarëve e para kam kërkesë qe te bëhet monitorim e pasurisë publike pasi qe po shkartohen shumë dhe duhet te vendosen kamerat e sigurisë sidomos te fushat e sportit. E dyta te bëhet vendosja e pengesave ne rrugë pasi qe po vozitet ne shpejtësi shumë të madhe. K1%rkesa e tretë, te shkolla e Banullës, janë hedhura disa kafshë të ngordhura nga dikush dhe aty duhet te intervenohet. Kërkesa e 4-të, mirëmbajtja e pronave publike pasi qe janë në gjendje te mjerueshme. Kërkesa tjetër higjiena në shkolla është në gjendje te mjerueshme kur pritet nga Ministria qe te bjer materialin për higjiene. Dhe e fundit ne grupi PDK-së, kemi vizituar Janjevën dhe aty është një organizata qe e udhëheq Majlinda Krasniqi, ajo aty bënë një punë shumë të mirë ku aty 6 ditë në javë bëhet aktivitete të ndryshme, dhe te gjitha komunitetet po përfshiheshin, por aty kish nevojë qe te ju behet një zgjidhje për një objekt qe ka hapësire me të madhe dhe ne si grup e përkrahim. Është shty afati edhe për dy vite për te dhunuarit gjatë luftës, është mirë përmes grupit te grave ta krijojmë një lidhje telefonike dhe ta ruajmë konfidencialitetin dhe te identifikojmë numrin dhe te aplikojnë, pasi qe kjo kategoria ka mbet pak jashtë dorës.

Fadil Spahiu, tha se pari ju uroj festen e Kurban Bajramit! Pastaj tha se unë kam për ti ngritur dy kërkesa dhe një pyetje:

Kërkesa e parë është për Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim. Duke u bazuar në përgjegjësit që kujdeset dhe monitoron funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve, sipërfaqeve të gjelbëruara dhe pastërtisë së vendbanimeve, kërkoj nga Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim që të intervenoj në kositjen dhe largimin e barojave në të dy skajet e rrugës, të cilat po e vështirësojnë lëvizja e këmbësorëve dhe biçikletave si dhe është zvogluar dukshmëria e rrugës për drejtuesit e automjeteve, për gjatë shtrirjes së rrugës 11 Qershori në fshatin Smallushë. E njëjta gjendje është edhe në rrugën e Lamës në fshatin Banullë, po ashtu edhe në fshatin Glllogoc si dhe në disa fshatra tjera, ku rrugët janë të ngushta, pa trotuar dhe me kthesa. Kërkesa e dytë është për Drejtorinë për Infrastruktura. Disa banorë të një lagjeje të fshatit Vrellë e Gadimes, kanë bërë kërkesë që në rrugë lidhësen me rrugën e quajtur Gjakova në fshatin Vrellë e Gadimes të ndërtohet një urë për kalimin e automjeteve në lumin të cilin kalon për gjatë asaj lagjeje edhe pse banorët e asaj lagjeje me mjete vet anakë i kanë vendosur disa gypa por nuk janë të mjaftueshëm për kalimin e ujit të lumit dhe qarkullimi i automjeteve po bëhet me vështirësi të mëdha. Me datë: 05.12.2022 këta banorë me anë të një shkrese kanë bërë kërkesë tek Drejtoria për Infrastrukturë dhe se kanë marruar përgjigjeje në kërkesë se nuk kemi pas mjete të planifikuara, andaj do të shohim mundësinë e sigurimit të mjeteve në planifikimet e ardhshme buxhetore. Pra kërkesa e këtyre qytetarëve është që të ndërtohet kjo urë sa më parë që është e mundur për të mundësuar qarkullimin e lirë të automjeteve. Pyetje për Drejtoratin për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim Pyetja shtrohet lidhur me kërkesën që e kam ngritur në mbledhjen e 18 me radhë. A është njoftuar kompania për mirëmbajtjen e ndriçimit publik për defektin e një shtylle të ndriçimit publik ku kabllot e energjisë elektrike të asaj shtylle kanë mbetur në trotuar dhe po e rrezikojnë jetën e qytetarëve që kalojnë në atë pjesë, e që siç e kam cekur edhe në mbledhjen e 18 me radhë, nëpër atë trotuar ku është zhvendosur shtylla e ndriçimit publik kalojnë të gjithë nxënësit e fshatit dhe se rrezikimi i jetës së tyre dhe i të tjerëve është evident? Po e bëj këtë pyetje sepse ka disa muaj që është shkaktuar ky defekt dhe ende nuk është riparuar. Ju bëj apel që të bëhet intervenimi sa ma parë që është e mundur, që të evitohet ndonjë fatkeqësi eventuale.

Lulzim Rrustemi, tha se ju uroj kurban bajramin të gjithë të pranishmeve, dhe e kam një pyetje për drejtorin e infrastrukturës trotuari që po rregullohet në Lipjan apo në fshatin Llugaxhi- Gadime për përfitime një here ndriçim publik, tani trotuari ky projekt shkon në dëme të taksave të qytetarëve, kur bëhet projekti shkon bashkë jo ndaras këto janë gabime fatale, pyetja e dytë ne kemi pasur një ankand publik për pronat bujqësore mendoj dhe propozoj që drejtori i bujqësisë të futë në ankand të ri pasi që këto prona bujqësore që 23 vite keqpërdoren ka raste kur pronën komunale e japin me qira te njerëzit e tjerë kjo nuk tolerohet, prandaj drejtori i bujqësisë dhe ekzekutivi duhet ti qesin në ankand sepse këto prona duhen të punohen dhe të shfrytëzohen nga qytetaret. Pyetja e tretë edhe pronat publike për investime të shpallen në ankand që t'i shfrytëzojnë nuk ka nevojë që këto prona të pushojnë ka 5-6 vite në të ju epen investitorëve të zhvillohen dhe të punësohen të rinjtë e Lipjanit. Dhe pyetja e katërt për dhunën e ushtruar ndaj grave dhe të mbijetuarat e luftës prandaj grupi i grave duhet të dalë me një propozim me koston buxhetore financiare që komuna e Lipjanit të ju dalë në ndihmë.

Ardit Cani, tha se edhe unë ua uroj Kurban Bajramin te gjithëve pastaj tha se do ti ngris disa çështje e para është kërkesë që e kam ngritur disa herë që ka të bëjë me rregullimin e trotuarit te uji i nxehtë në Bainsë pasi që aty është duke u bërë zonë turistike dhe aty ka te punësuar mbi 30 persona. E dyta ndërtimi i një salle te mbrëmshme sportive në Bainsë ne hapësirën shkollore. E treta vendosja e shenjave që ndalon hedhjen e mbeturinave ne fshatrat Bainsë Resinovc dhe Shalë ku ne disa vende po krijohen deponi ilegale kërkoj nga inspektorati që dal ne teren duke i eliminuar këto . E fundit te behet rregullimi i ndriçimit ne fushën sportive ne Bainsë.

Shahadije Gragaçina, tha se kam një pyetje se a është bërë vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut te fundit në Janjevë dhe sa familje kanë aplikuar për dëmet e shkaktuara dhe si do te ju ndal në ndihmë komuna e Lipjanit. E dyta kam një kërkesë të banorëve të rrugës Fahri Fazliu në lagjen e Akllapit pse ende nuk është bërë ende asfaltimi i kësaj rruge.

Besiana Sylja, tha se edhe unë ua uroj Kurban Bajramin, kam disa çështje për ti ngritur e para ka të bëjë me fshatin Topliqan ku mungojnë gjërat elementare ska ujësjellës dhe i gjithë fshati pine ujë nga një qeshmë. Dhe që sa vite nuk është bërë asnjë investim në këtë fshat.

Gentianë Hoxhaj, tha se a ka pas investime ose jo në Topliqan është dëshmuar me 17 tetor.

Besiana Syla, tha se unë po flas ne bazë të banorëve dhe aty janë shtruar vetëm dy rrugë por mungon ujësjellësi. Dhe aty mungojnë gjëra elementare.

Daut Azemi, kryesues i kuvendnit tha se pari është mirë mos me ndërhy kur pyet dikush, unë kush e kërkon fjalën ia epi fjalë, por mos ndërhyjni nga vendi. E dyta unë jam nip i Topliqanit dhe ne Topliqan janë bërë shumë investime, kërkesat kur te bëhen duhet te jenë reale.

Alban Salihu, tha se çështjen e parë që kisha ta ngrit është që e tha deputeti Rrustemi është gabim jo planifikim i duhur investimi i ndriçimit ne fshatin Gadime investim jo i duhur këto kanë kosto financiare, çështja e dytë është gjatë disa vizitave që kam bere ne lagjen e “Bytyqve” në fshatin Sllovi gjatë bisedave me qytetarët ata janë ankuar që nuk ka investimeve ne atë vend edhe pse janë premtuar. Janë rregullimi i shtratit të lumit, rregullimi i ndriçimit, rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve, rregullimi i dheut te vendi i të pamës, rregullimi i stacionit të autobusëve, rregullimi i rrugës 700m. Banorët e fshatit than se këto premtime janë bërë po nuk janë realizuar kur po shkojmë ne komunë për të parë pse nuk po kryhen këto investime nuk kemi asnjë përgjigje. I ftoj ekzekutivin që ti merr parasysht këta qytetarë ne takim që të kryhen këto investime.

Rinor Murati, tha se kam dy çështje për t’i ngritur e para ka te beje me vërshimet e fundit që kanë ndodhur ne vendin tonë ku janë prekur me se shumti bujqit. Kam një pyetje për drejtorin e bujqësisë, se a është bere ndonjë komision që do ta bëje vlerësimin e dëmeve në mënyre që të ju ndihmoje këtyre buqëve. E dyta ka të bëje me sigurinë në shkolla ku e prek edhe komunën tonë, po sipas ministrisë ka rënje të numrit të rasteve. Çfarë rekomandimi ka dhënë në DKA-ja sa i përket kësaj çështje.

Bashkim Budakova, tha se kam një pyetje për ekzekutivin, kompleksi i sporteve “Beter life” ku dikur proklamohej se është me ato te Zvicres ndërsa sot e kemi ne gjendje të mjerueshme ku rrethojat ulëset, portat dhe ndriçimi janë jashtë funksionit.

Lumturie Bytyqi- Hasani, tha se unë e përkrahi mendimin e Ganimetës për nderimin e disa figurave gra të i kanë dhënë shumë këtij vendi, ndër to janë motra Lide dhe profesoresha Hajrie dhe do të ishte mirë që komuna dhe komisioni ti nderoj këto figura ku kanë dhënë kontribute barabar me burra, janë heroina të vërteta të vendit tonë.

Diamant Bytyqi, tha se i urojë festën e Kurban Bajramit të gjithë të pranishmeve, po fillojmë për pyetjen prej Albionës që e pate pyetjen për kanalizimin në Akllap po besoj që shumë shpejt do të rregullohet kjo qeshtje sepse kemi pasur probleme me

pronësinë dhe shtrirjen e rrjetit të kanalizimit kështu që këto probleme janë kaluar dhe gjatë këtij vitit shpresoj që të rregullohet kjo çështje. Ganimetja e patë pyetjen me emërtimin e rrugëve dhe sheshit, sepse tash e kemi një komision në teren për

Pasi që çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 19-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 18 e Kuvendit, pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 27 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja 17-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Propozim vendim mbi aprovimin e Korinizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit, dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 19 vota për, 11 kundër, aprovoi Vendimin.

III

Propozim Vendim per miratimin e planit komunal per riintegrim te qendrushem te eproanve te riatdhesuar dhe integrim te te hujave ne komunen e Lipjanit 2023-2025

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit drejtor i DSHPS-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, aprovoi Vendimin.

IV

Propozim Vendim per ndarjen e mjeteve financaiare Organizates "HELP"

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemit, ia kaloi fjalën Valon Pacollit, drejtor i DEZH i cili i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi?

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi Vendim

IV

5. Propozim vendim per dnrarjen e mjeteve financaire per qendren per mbrojtje te viktimave te dhunes familjare dhe atyre te dhunes gjinore.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit, DSHPS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi propozimin

V

Propozim vendim per pezullimin e eprkoshem te zbatimit te rregullores per orarin e veprimtarive ekonomike Nr.15-330/02-22376 te datës, 28.04.2023

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacolli, drejtor i DEZH-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 për,4 kundër , aprovoi propozimin.

VI

Propozim rregullore per transportin e udhetarve me automjete taksi (Rishqyrtim).

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Burim Rrustemi, drejtor i SHPMSH-së, i cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për, aprovoi Vendim

VII

Propozim Vendim për Anulimin e Vendimi 15NR.353/01-27907 i datës 31.05.2023 për caktimin e lokacionit për fushën sportive në zonën kadastrale Babush i Muhaxherëve i miratuar në mbledhjen e Kuvendit të mbajtur me datë 31.05.2023

.Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën, Anila Reqica-Llugiqi, drejtoreshë e DKRS-se, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 16 vota për, dhe 1 abstenim aprovoi Vendim

VIII

Propozim Vendim për Anulimin e Vendimit 15NR.353/01-27908 i datës 31.05.2023, për caktimin e lokacionit për vendosjen e Memorialit të UÇK-së në zonën kadastrale Qylagë

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën, Anila Reqica-Llugiqi, drejtoreshë e DKRS-se, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 16 vota për dhe 1 abstenim, aprovoi Vendimin

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15:00.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi